



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË**  
**TIRANË**

**NR. 2586 REGJISTRI**  
**Data 10.03.2016 Regjistrimi**

**NR. 2297 VENDIMI**  
**Datë 10.05.2016**

**VENDIM**

**"Në emër të Republikës"**

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e përbërë nga:

**Gjyqtari Avni SEJDI**

Asistuar nga sekretaria gjyqësore **Griselda DORESI**, në Tiranë sot me datë 10.05.2016, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen administrative nr. 2586 akti me palë ndërgjyqëse:

**PADITËS:** Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, përfaqësuar në gjykim nga Z. Isidor Frashni, pajisur me autorizim Nr. 5449 prot, datë 21.03.2016, identifikuar me letërnjoftim nr. 032806336.

**I PADITUR:** Drejtoria e Apelimit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në mungesë.

**PERSON I TRETË:** Subjekti Lek Prenga me NIPT L59501002B, me administrator Z. Lek Prenga, me adresë: Fan, Klos, Lagjja Qendër, Ndërtesë 1-katëshe, Mirditë, në mungesë.

Avokatura e Shtetit Zyra Vendore Tiranë, në mungesë.

**OBJEKTI:** Shfuqizimin e vendimit nr. 37370/5 prot, datë 09.02.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë.

Lënien në fuqi të aktit administrativ Njoftim Vlerësimi Nr. 10363 prot, datë 06.11.2015 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë.

**BAZA LIGJORE:** Ligji nr. 9920/2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* dhe Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008 i MF në zbatim të tij; Ligji nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*;

Gjykata si mori në shqyrtim çështjen, si shqyrtoi dhe administroi provat e paraqitura nga palët, si dëgjoi bisedimet përfundimtare të tyre të cilët në përfundim kërkuan:

**Përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë, Z. Isidor Frashni:**

Pranimin e kërkesëpadisë.

**Në mungesë të palës së paditur Drejtoria e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe personit të tretë Z. Lek Prenga,** të cilat ndonëse kishin dijeni rregullisht për ditën dhe orën e gjyimit, pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk u paraqitën.

Gjykata si shqyrtoi aktet dhe e bisedoi në tërësi çështjen.

## **VËREN**

Paditësi Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar sipas objektit.

Gjykata, në mbështetje të nenit 7 gërma “a” 10/1, dhe 11/1 të ligjit nr. 49/2012 *“Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”*, si dhe 36 të Kodit të Proedurës Civile, kryesisht konstaton se, është kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore për gjykimin e kësaj çështje dhe se mosmarrëveshja në fjalë bën pjesë në juridiksionin gjyqësor.

Për të bërë të mundur përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të shtetit në këtë gjykim, në zbatim të nenin 79/a të K.Pr.Civile, kërkesëpadia dhe aktet iu njoftuan Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Tiranë, e cila ndonëse u njoftua rregullisht për çdo seancë gjyqësore me anë të fletëthirrjes respektive pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk u paraqit.

• **Rrethanat e çështjes:**

Personi i Tretë Lek Prenga është regjistruar si Person Fizik pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë me NIPT L59501002B, me adresë; Fan, Klos, Lagjja "Qendër", Ndërtesë 1-Katëshe, Lezhë dhe ushtron aktivitet në fushën e tregtimit me pakicë të artikujve ushqimorë.

Në datën 17.09.2015, inspektorët e Verifikimit në Terren të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë, bazuar në urdhrin e punës nr. 412 datë 14.09.2015 kanë ushtruar kontroll në vendin e ushtrimit të biznesit të personit të tretë të ndodhur në adresën e sipërcituar dhe kanë mbajtur akt-konstatimin nr. 0515158 datë 17.09.2015, në të cilin ndër të tjera thuhet:

*Subjekti është i regjistruar në QKR dhe organin tatimor DRT Lezhë me NIPT L59501002B dhe SN-329075-09-15.*

*Subjekti nuk është i pajisur me kasë fiskale por e ka bërë pagesën për tu pajisur me të me datë 15.09.2015.*

*Subjekti nuk është furnizuar me dëftesa tatimore. Në momentin e kontrollit u gjend në punë Z. Lek Prenga."*

Bazuar në këtë akt-konstatim, në vijim të procedurave, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë ka nxjerrë aktin administrativ, objekt ankimi, Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore nr. 10363 prot, datë 06.11.2015 për gjobë në vlerën 50.000 lekë për "Moslëshim fature a kuponi tatimor".

Ndaj këtij akti, personi i tretë Lek Prenga ka paraqitur ankim administrativ, pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila me vendimin nr. 37370/5prot, datë 09.02.2016 ka vendosur:

- 1- Lënien në fuqi të aktit administrativ "Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore" nr. 10363 prot, datë 06.11.2015 të nxjerrë nga DRT Lezhë për gjobë në masën 10.000 lekë për mosmbajtjen e saktë të dokumentacionit.
- 2- Shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore" nr. 10363 prot, datë 06.11.2015 të nxjerrë nga DRT Lezhë për gjobë në masën 40.000 lekë.

Duke mos qenë dakord me këtë vendimmarrje të Drejtorisë së Apelit Tatimor, pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë i është drejtuar me kërkesëpadi gjykatës duke kërkuar sipas objektit.

- **Pretendimet e palëve:**

#### **Paditësi:**

Në kërkesëpadinë e paraqitur për gjykim si dhe gjatë gjykimit, nga pala paditëse në mënyrë të përmblëdhur u pretendua si më poshtë:



1. Verifikimet në vendin e ushtrimit të biznesit kryhen pa njoftimin paraprak të personit të tatueshëm, por vetëm nëpërmjet prezantimit në momentin e verifikimit nëpërmjet dokumentit personal të identifikimit të verifikuesit dhe urdhrit të punës. Në zbatim të urdhrit të punës nr. 412 prot, datë 14.09.2015, inspektorët e verifikimit në terren kanë ushtruar kontroll në vendin e ushtrimit të biznesit të personit të tretë, dhe kanë mbajtur akt-konstatimin nr. 0515158 datë 17.09.2015, në të cilin ndër të tjera thuhet: *“Në momentin e kontrollit subjekti nuk është pajisur me kasë fiskale dhe nuk është furnizuar me dëftesa tatimore. Në momentin e kontrollit subjekti ishte duke ushtruar aktivitetet.”*

2. Për shkak të kësaj kundërvajtje administrative, paditësi është penalizuar me gjobë 50.000 lekë me "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet" nr. 10363 prot, datë 06.11.2015 akt i cili është nxjerrë në përputhje me nenin 122 të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* dhe për pasojë duhet të lihet në fuqi.

3. Vendimi nr. 37370/5prot, datë 09.02.2016 i DAT është nxjerrë në kundërshtim me ligjin, pasi nga ana e inspektorëve është konstatuar se subjekti ushtron aktivitet dhe jo të kundërtën siç pasqyron DAT në vendimin e saj, dhe aktiviteti nuk ushtrohet nëse nuk kryhen blerje apo shitje.

- **Analiza e provave në lidhje me faktin dhe ligjin e zbatueshëm:**

#### **Në lidhje me legjitimitimin e palëve:**

Sipas nenit 32 të K.Pr.Civile padia mund të ngrihet:

- a) *për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur.*

Në kuptim të kësaj dispozite procedurale civile, që të justifikohet ligjërisht kërkitimi për njohjen ose rivendosjen e një të drejte të shkelur ose të mohuar, kjo duhet të bëhet vetëm prej atij që i përket sipas ligjit e drejta e mohuar ose e shkelur prej një të treti (*legjitimim aktiv*) dhe vetëm kundra atij që me veprën e tij, mohon ose shkel të drejtën e kërkuarit (*legjitimim pasiv*).

Interesi i ligjshëm gjendet i pasqyruar dhe në dispozita të tjera proceduriale që rregullojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Kështu sipas **nenit 15 të ligjit nr. 49/2012** "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të drejtën e ngritjes së padisë e ka:

- a) *çdo subjekt, që pretendon se i është cënuar një e drejtë apo një interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik;*

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave proceduriale del se personi fizik apo juridik mund të kërkojnë zgjidhjen e konfliktit administrativ nëse plotësohen apo përmbushen dy kushte:

**Së pari;** akti administrative duhet të jetë i paligjshëm.

**Së dyti;** paditësi të jetë cënuar në interesat e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Legjitimiteti i palës në një proces gjyqësor nënkupton interesin legjitim dhe të vërtetë që duhet të ekzistojë ndërmjet palës dhe çështjes në shqyrtim.

Neni 32 i K.Pr.Civile, si dhe neni 15 i ligjit nr.49/2012, e kondicionon të drejtën e paditësit për të ngritur padi me interesin e ligjshëm që duhet të ketë ai për njohjen ose rrëzimin e një pretendimi. Interesi i ligjshëm lidhet me të drejtën e palës për të kërkuar nëpërmjet gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejtë të mohuar ose të cënuar prej dikujt tjetër.

**Ligji i posaçëm nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH"**, i ndryshuar në neni 109, pika 3 të tij, ka parashikuar se; "Administrata tatimore, e cila ka nxjerrë vendimin administrativ, objekt ankimi, mund ta apelojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim".

Sa më sipër, bazuar në nenin 32/a të K.Pr.Civile, nenin 15/a të ligjit nr. 49/2012 dhe nenin 109 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar, pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, gëzon legjitimitet aktiv në këtë gjykim, për të kundërshtuar aktin administrativ objekt gjykimi, Vendimin nr. 37370/5 prot. datë 09.02.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Po ashtu, pala e paditur, Drejtoria e Apelimit Tatimor në DPT, gëzon legjitimitet pasiv në këtë gjykim, pasi akti administrativ i sipërcituar i kundërshtuar për pavlefshmëri, objekt i këtij gjykimi, është nxjerrë pikërisht nga ky organ.

Sa më sipër si paditësi, ashtu dhe pala e paditur gëzojnë legjitimitet aktiv dhe pasiv në këtë gjykim.

### **Në lidhje me juridiksionin:**

Sipas neni 137, paragrafi 3-te të K.Pr.Administrative, *(ankimi administrativ)* "Në parim palët e interesuara mund ti drejtohen gjykatës vetëdijëse të kenë ezauruar rekursin administrative".



Po ashtu, **ligji i posaçëm nr.49/2012** "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" në nenin 16 pika 1 të tij, ka parashikuar si kusht shterimin e ankimit administrativ para se subjekti ti drejtohet gjykatës.

Sipas pikës 2 të nenit 16 të ligjit të sipërpërmendur, përjashtohen nga ky rregull rastet kur:

a) ligji nuk parashikon organ më të lartë për paraqitjen e ankimit administrativ, ose kur organi më i lartë administrativ nuk është konstituuar;

b) ligji parashikon shprehimisht të drejtën për t'u ankuar ndaj veprimit administrativ drejtpërdrejt në gjykatë;

c) organi më i lartë në shqyrtimin e një ankimi administrativ ka cenuar, me vendimin e tij, të drejtat apo interesat personale të ligjshëm të një personi, i cili nuk ka qenë palë në procedimin administrativ.

**Ligji i posaçëm nr. 9920 datë 19.05.2008** "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar në neni 109, pika 3 të tij ka parashikuar se; "Administrata tatimore, e cila ka nxjerrë vendimin administrativ, objekt ankimi, mund ta apelojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim".

Nga sa shihet, ligji i posaçëm, ai me nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, ka parashikuar se administrata tatimore e cila ka nxjerrë vendimin administrativ, objekt ankimi, mund ta apelojë vendimin e drejtorisë së apelimit tatimor drejtpërdrejt në gjykatë, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për këtë vendim".

Sa më sipër, në mbështetje të nenit 16, pika 2, germa "b" të ligjit nr.49/2012 *Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*" paditësi legjitimohen për t'iu drejtuar drejtpërdrejt gjykatës me padi për të

kërkuar rivendosjen e së drejtës së saj të pretenduar, si të shkelur apo cënuar nga pala e paditur dhe se çështja në fjalë bën pjesë në juridiksionin gjyqësorë.

**Në lidhje me paligjshmërinë e aktit administrativ të pretenduar:**

Ashtu siç u citua më sipër, në datën 17.09.2015 inspektorët e Verifikimit në Terren të Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë, bazuar në urdhrin e punës nr. 412 datë 14.09.2015 kanë ushtruar kontroll në vendin e ushtrimit të biznesit të personit të tretë Lek Prenga dhe kanë mbajtur akt-konstatimin nr. 0515158 datë 17.09.2015, në të cilin ndër të tjera thuhet:

*Subjekti është i regjistruar në QKR dhe organin tatimor DRT Lezhë me NIPT L59501002B dhe SN-329075-09-15.*

*Subjekti nuk është i pajisur me kasë fiskale por e ka bërë pagesën për tu pajisur me të me datë 15.09.2015.*

*Subjekti nuk është furnizuar me dëftesa tatimore. Në momentin e kontrollit u gjend në punë Z. Lek Prenga."*

Bazuar në këtë akt-konstatim, në vijim të procedurave, Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë ka nxjerrë aktin administrativ, objekt ankimi, Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore nr. 10363 prot, datë 06.11.2015 për gjobë në vlerën 50.000 lekë për "Moslëshim fature a kuponi tatimor".

Ndaj këtij akti, personi i tretë Lek Prenga ka paraqitur ankim administrativ, pranë Drejtorisë së Apelit Tatimor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, e cila me vendimin nr. 37370/5 prot, datë 09.02.2016 ka vendosur:

- 1- Lënien në fuqi të aktit administrativ Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore nr. 10363 prot, datë 06.11.2015 të nxjerrë nga DRT Lezhë për gjobë në masën 10.000 lekë për mosmbajtjen e saktë të dokumentacionit.
- 2- Shfuqizimin e aktit administrativ Njoftim Vlerësimin për Detyrimet Tatimore nr. 10363 prot, datë 06.11.2015 të nxjerrë nga DRT Lezhë për gjobë në masën 40.000 lekë.

Pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë nuk është dakord me vendimmarrjen e palës së paditur, për këtë arsye i është drejtuar me kërkesëpadi gjykatës, duke kërkuar shfuqizimin e vendimi nr. 37370/5 prot, datë 09.02.2016 të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Në lidhje me sa u pretendua nga ana e palëve në këtë gjykim, gjykata, referuar rrethanave të faktit, provave të shqyrtuara në seancë gjyqësore si dhe shkakut ligjorë të padisë, çmon se

kërkimet e palës paditëse janë të pabazuara në ligj dhe se kërkesëpadia e paraqitur prej tij duhet rrëzuar, duke arsyetuar si më poshtë:

Në nenin 54 paragrafi i tretë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2000 "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar parashikohet: "Të gjithë tatimpaguesit e shitësve me pakicë, që shesin mallra apo ofrojnë shërbime në mjedise apo njësi të përhershme, që hapura për publikun, duhet të instalojnë pajisje fiskale dhe të lëshojnë kupona tatimore për çdo transaksion."

Ndërsa, neni 55 paragrafi i parë i ligjit të sipërcituar parashikon: 7.1. Tatimpaguesit, që kryejnë qarkullimin e mallrave dhe të shërbimeve, për të cilat pagesat nuk kryhen nëpërmjet bankës, janë të detyruar të instalojnë dhe të përdorin sistemin fiskal, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve fiskale, për regjistrimin e pagesave me para në dorë dhe për lëshimin, në mënyrë të detyrueshme, të kuponit tatimor.

Po ashtu, në paragrafin 47.1.3 dhe 47.1.5 të Udhëzimi nr. 24 datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në RSH" parashikohet:

47.1.3 Personi i tatueshëm shitës me pakicë, tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, për çdo shitje në njësitë e shitjes me pakicë, të kryer për individë konsumatore finale, është i detyruar të lëshojë kupon tatimor me arke regjistruese dhe në mungesë të saj dëftesë tatimore.

47.1.5 Dëftesa tatimore lëshohet nga të gjithë personat e tatueshëm shitës me pakicë tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, të cilët nuk janë të pajisur me arke regjistruese ose që, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.781, datë 14.11.2007 nuk janë të detyruar të pajisen me arke regjistruese ose arka regjistruese e të cilëve për çfarëdo arsye nuk është në gjendje pune. Rolin e dëftesës tatimore mund ta luajnë edhe dokumente të tjera të miratuara në akte të tjera ligjore apo nënligjore, si për shembull biletat e transportit të udhëtarëve.

Referuar dispozitave të sipërcituara, në mungesë të pajisjes fiskale, tatimpaguesi ka pasur detyrimin për tu pajisur me dëftesën tatimore. Sipas akt-konstatimit nr. serie 0515158 datë 17.09.2015 rezulton se subjekti nuk është pajisur me kasë fiskale dhe nuk është furnizuar me dëftesa tatimore, por ky kontroll përveç këtyre fakteve nuk ka evidentuar kryerjen e transaksionit me lekë në dorë të kryer në mungesë të dëftesës tatimore.

Në nenin 47 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2000 "Për procedurat tatimore në RSH" i ndryshuar parashikohet: Tatimpaguesit, që janë subjekt i ligjit "Për sistemin e taksave vendore", për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera, si dhe lëshojnë një faturë të thjeshtë tatimore apo kupona tatimore, në përputhje me



dispozitat e ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", si dhe dispozitat e ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat".

Ndërsa në nenin 57 pika 4 të ligjit të sipërcituar parashikohet: "Tatimpaguesit, subjekte të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", për përlllogaritjen e detyrimit tatimor, mbajnë regjistra, libra dhe dokumente të tjera, si dhe lëshojnë fatura të thjeshta tatimore, dëftesa tatimore dhe kupona tatimore, në përputhje me ligjin e fushës dhe me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Gjithashtu, këta tatimpagues mbajnë dokumentacion tatimor, sipas kërkesave të këtij ligji, të ligjeve specifike tatimore dhe të dispozitave nënligjore, të dala në zbatim të tyre.

Mosmbajtja e saktë e dokumentacionit tatimor nga ana e subjektit tatimpagues përbën kundërvajtje administrative sipas nenit 118 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2000 **"Për procedurat tatimore në RSH"** dhe dënohet me gjobë 10.000 lekë për tatimpaguesin e klasifikuar si biznes i vogël dhe 50.000 lekë kur tatimpaguesi është klasifikuar si lloj tjetër biznesi.

Sa më sipër, në kushtet kur në momentin e kontrollit të ushtruar nga ana e inspektorëve tatimorë, ka rezultuar se subjekti nuk është pajisur me kasë fiskale dhe nuk është furnizuar me dëftesa tatimore, por ky kontroll përveç këtyre **fakteve nuk ka evidentuar kryerjen e transaksionit me lekë në dorë të kryer në mungesë të dëftesës tatimore, me të drejtë nga pala e paditur Drejtoria e Apelit Tatimor është bërë ndryshimi i sanksionit nga 50.000 lekë në 10.000 lekë, pasi nuk ndodhemi përpara kundërvajtjes administrative të moslëshimit të faturës, dëftesës tatimore apo kuponit tatimor, por përpara asaj të mosmbajtjes së saktë të dokumentacionit tatimor nga ana e subjektit tatimpagues.**

Sa më sipër, gjykata çmon se Vendimi nr. 37370/5 prot, datë 09.02.2016 i Drejtorisë së Apelit Tatimor i cili ka ndryshuar "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore" nr. 10363 prot, datë 06.11.2015 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, është një akt administrativ i marrë në përputhje me ligjin dhe si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Përfundimisht nga sa u analizua më sipër, gjykata arrin në përfundimin se kërkesëpadia e paraqitur nga pala paditëse Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, është e pabazuar në ligj e në prova, dhe si e tillë ajo duhet rrëzuar.

Sipas nenit 45 të ligjit nr. 49/2012 **"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"**, nuk lejohet ankim ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës administrative për padi me objekt:

- a) kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi;

Sipas VKM nr.573 datë 03.07.2013, paga minimale në shkallë vendi është 22.000 (njëzet e dy mijë) lekë.

Referuar Vendimit nr. 37370/5 prot, datë 09.02.2016 i Drejtorisë së Apelit Tatimor i cili ka ndryshuar "Njoftim Vlerësimi për Detyrimet Tatimore" nr. 10363 prot, datë 06.11.2015 të nxjerrë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, rezulton se personi i tretë Lek Prenga është dënuar me gjobë në shumën 50.000 lekë, shumë kjo që rezulton të jetë më e vogël se njëzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, çka do të thotë se ky vendim është i paankimueshëm, kjo në bazë të dispozitës ligjore të sipërcituar.

Sa më sipër, në zbatim të nenit 45 të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", ky vendim është i paankimueshëm, dhe merr formë të prerë nga data e shpalljes së këtij vendimi.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata bazuar në nenet 126 e 306 të K.Pr.Civile, nenin 40/3 dhe 45 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

### VENDOSI

- Rrëzimin e kërkesëpadisë së paraqitur nga paditësi Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, si të pabazuar në ligj dhe në prova.
- Shpenzimet gjyqësore lihen në ngarkim të palës paditëse.
- Në zbatim të nenit 45/a të ligjit nr. 49/2012, ky vendim është i paankimueshëm dhe i formës së prerë.
- U shpall në Tiranë sot me datë 10.05.2016.

SEKRËTARE

Griselda DORESI

Dore

